



Raport

për procesin e konsultimeve gjatë përgatitjes së propozim-ligjeve, përdorimin e RVEN-it dhe mekanizmave tjerë për bashkëpunim me organizatat qytetare në vitin 2022

Shkup, prill 2023

1. HYRJE

Konsultimet me shoqërinë civile në proceset e krijimit të politikave dhe miratimit të ligjeve dhe akteve të tjera përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të procesit modern, demokratik të menaxhimit të politikave publike, por edhe një nga hapat kyçe në forcimin e bashkëpunimit, dialogut dhe besimit ndërmjet Qeverisë së Republika e Maqedonisë së Veriut dhe shoqëria civile.

Kodi i praktikave të mira për pjesëmarrjen e sektorit civil në procesin e krijimit të politikave¹ përcakton se bashkëpunimi i Qeverisë dhe organeve të administratës shtetërore me sektorin civil në procesin e krijimit të politikave mund të realizohet në formën e: informimit, konsultimeve, dialogut dhe partneritetit, në të gjitha fazat e procesit të krijimit të politikave: në proceset e përcaktimit të prioriteteve në krijimin e politikave në përgatitjen e Programit vjetor të Punës së Qeverisë, në përgatitjen e ligjeve dhe akteve nënligjore, dokumenteve për politika dhe strategji dhe planet e veprimit, në proceset e zbatimit, monitorimit apo ndryshimit të legjislacionit. Në bazë të nenit 14 të Kodit, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë një herë në vit publikon thirrje për sektorin civil për kontribut në përgatitjen e Programit vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.


Regjistri i Vetëm Elektronik Nacional i Rregulloreve (RVEN) është një pikë qendrore ku shpallen propozim-ligjet para se të dorëzohen në procedurë qeveritare dhe i nënshtrohen komenteve nga palët e përfaqësuara. RVEN është një mjet i cili vazhdimisht zhvillohet dhe përdorimi i tij nga palët e përfaqësuara është me rëndësi të veçantë për procesin e përgjithshëm të konsultimeve dhe miratimit të ligjeve.

Ky raport është përgatitur në bazë të analizës së të dhënave të Regjistrit të Vetëm Elektronik Nacional të Rregulloreve (RVEN) dhe përgjigjeve të Pyetësorit për mekanizmat e konsultimeve me organizatat qytetare gjatë përgatitjes së propozim-ligjeve dhe akteve të tjera në vitin 2022, me çka Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë – njësi organizative për bashkëpunim me organizatat qytetare, ua ka shpërndarë ministrive përmes anëtarëve të Rrjetit të nëpunësve shtetërorë për bashkëpunim me shoqërinë civile. Raporti përmban të dhëna për propozim-ligjet, të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar-dhjetor 2022 dhe të dorëzuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me çka nuk përfshihen propozim - ligjet që janë tërhequr nga Qeveria nga procedura parlamentare.

2. Konsultimet me organizatat qytetare gjatë përgatitjes së Programit Vjetor të Punës së Qeverisë

Sekretariati i Përgjithshëm - njësia organizative për bashkëpunim me organizatat qytetare, në faqen e internetit www.nvosorabotka.gov.mk dhe në Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional të Rregulloreve (RVEN), çdo vit publikon thirrje për sektorin e shoqërisë civile për kontribut në përgatitjen e Programit Vjetor të Punës së Qeverisë. Thirrja publikohet në gjysmën e dytë të gushtit dhe zgjat deri më 15 shtator. Iniciativat dhe propozimet e pranuar nga organizatat qytetare publikohen në www.nvosorabotka.gov.mk në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të propozimit, ndërsa në afat prej 30 ditësh publikohen informacionet e mara nga ministritë kompetente dhe organet tjera të administratës shtetërore për rëndësinë dhe pranimin e propozimit.

Pas Thirrjes për kontribut të sektorit civil në përgatitjen e Programit të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023, i publikuar më 17.8.2022, janë dorëzuar gjithsej 17 propozime nga 12 organizata qytetare. Propozimet i janë përcjellë ministrive resorë dhe organeve të tjera të administratës shtetërore, të cilat kanë dorëzuar gjithsej 16 përgjigje për 8 propozime të organizatave të qytetare. Ministritë resore në shumicën e rasteve mbështesin iniciativat e organizatave të qytetare dhe deklarojnë se do të kenë parasysh propozimet e dorëzuara gjatë hartimit të rregullativës përkatëse ligjore, strategjisë apo planit të veprimit, në një numër të caktuar rastesh sugjerojnë se është e nevojshme analiza shtesë apo formimi i një grupi të punës me përfaqësues të disa institucioneve, dhe vetëm në një numër të vogël të rasteve deklarojnë se propozimi nuk mund të pranohet, duke shpjeguar arsyet për këtë.




3. Pjesëmarrja e organizatave qytetare në përgatitjen e propozim-ligjeve (konsultimet përmes RVEN dhe formave të tjera të pjesëmarrjes)

Në periudhën janar-dhjetor 2022, nga gjithsej 94 propozim - ligje të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 33 nuk i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit të




rregullativës (VNRr). Nga 61 propozim - ligje që i nënshtrohen VNRr, 24 (39.34%) janë publikuar në Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional të Rregulloreve (RVEN). Cilësia e Raporteve për VNRr në pjesën e Konsultimeve nuk është në nivel të kënaqshëm. Në 15 raporte (42.9%) në këtë pjesë janë renditur vetëm palët e përfaqësuar ose institucionet nga të cilat është kërkuar mendim. Shembuj të një Raporti për VNRr-së të plotësuar përkatëse në pjesën Konsultime janë: Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektimin Teknik dhe Propozim-ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (Ministria e Ekonomisë), Propozim-ligji për Zooteknikën (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave) dhe Propozim-ligji për shpalljen e Studeniçishko Bllato si zonë e mbrojtur - Park i Natyrës (Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor).



Përkundër obligimit të përcaktuar në nenin 68-a të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, propozim-ligjet Ministria kompetente t'i publikojë në faqet e saj të internetit dhe në Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional të Rregulloreve, pjesë e propozim-ligjeve të përcaktuara nga Qeveria në vitin 2022 nuk janë publikuar në RVEN si mjet për informim dhe konsultim me palët e përfshira. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave kanë mundësuar konsultime përmes RVEN për rreth gjysmën e ligjeve të përcaktuara; Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave publikuan një pjesë të vogël të propozim-ligjeve në EVEN, ndërsa Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në vitin 2022 nuk e kanë përdorë fare RVEN si mjet për informim dhe konsultime me palët e përfshira. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Mbrojtjes kanë zhvilluar konsultime nëpërmjet RVEN për të gjitha ligjet e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022.





Nga 24 propozim-ligje të publikuara në RVEN, për 11 propozim-ligje (47.83%) janë dorëzuar gjithsej 43 komente nga palët e përfshira, nga të cilat 10 (23.26%) janë dorëzuar nga organizatat qytetare për 5 propozim-ligje.





Tabela 1: Lista e 11 propozim – ligjeve për të cilat janë dorëzuar komente në RVNE


Ligji	Propozues	Numri i komenteve të RVNE ³	Numri i komenteve nga OQ
Propozim - ligji për Parandalimin e Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit	Ministria e Financave	11	/
Propozim - ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje	Ministria e Drejtësisë	2	2
Propozim – ligji për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave	Ministria e Financave	10	3

Propozim – ligji për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimin e Konformitetit	Ministria e Ekonomisë	1	/
Propozim – ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve	Ministria e Ekonomisë	3	1
Propozim – ligji për shpalljen e Studençishko Bllato si zonë e mbrojtur - Park i Natyrës	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	3	2
Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Energjetikë	Ministria e Ekonomisë	4	/
Propozim – ligji për Ekspertizë	Ministria e Drejtësisë	2	/
Propozim – ligji për Kooperativa	Ministria e Ekonomisë	1	/
Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatim mbi Vlerën e Shtuar	Ministria e Financave	2	/
Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shoqëri Financiare	Ministria e Financave	4	2
Numri i përgjithshëm i komenteve në RVNE dhe numri i përgjithshëm i komenteve nga Organizatat qytetare.		43	10

Lista e 5 propozim – ligjeve të publikuara në RVNE me komente nga organizatat qytetare



Në përputhje me përgjigjet e Pyetësorit për mekanizmat e konsultimit me organizatat e qytetare gjatë përgatitjes së propozim – ligjit dhe akteve të tjera në vitin 2022, ministritë kanë formuar grupe të punës për 26 propozim – ligje dhe përfaqësues të organizatave qytetare kanë qenë të përfshirë në grupet e punës për 12 ligje (46,15 %).



Sipas përgjigjeve të marra nga pyetësi, shumica e ministrive kanë formuar grupe të punës vetëm për disa propozim – ligje në vitin 2022, me përjashtim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, e cila ka krijuar grupe të punës për të gjitha propozim-ligjet të cilat janë në kompetencë të saj. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve kanë deklaruar se nuk e kanë praktikuar këtë mekanizëm për konsultime gjatë vitit 2022.


Tabela 2: Lista e propozim-ligjeve për të cilat ishin formuar grupet e punës dhe pjesëmarrja e organizatave qytetare në grupet e punës në vitin 2022

Propozues	Propozim - ligjet për të cilat ishin formuar grupet e punës në vitin 2022	Propozim – ligjet për të cilat OQ kanë marrë pjesë në grupet e punës
Ministria e Punëve të Brendshme	Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontroll Kufitar	
Ministria e Drejtësisë	Propozim – ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje	✓
Ministria e Financave	Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar	
Ministria e Financave	Propozim- ligji për ndryshimin e Ligjit për Kthimin e një pjese të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për Personat Fizik	
Ministria e Ekonomisë	Propozim – ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve	✓
Ministria e Ekonomisë	Propozim – ligji për Kooperativat	✓
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	Propozim - ligji për Krijimin e Sistemit Këshillues në Bujqësi dhe Zhvillim Rural	✓
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	Propozim – ligji për Prodhimin Bujqësor Organik	
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	Propozim – ligji për Peshkim dhe Akuakulturë	
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	Propozim – ligji për Verë	✓
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	Propozim – ligji për Sigurimin e Detyrueshëm në Bujqësi	


Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	Propozim – ligji për Zooteknikë	✓
Ministria e Shëndetësisë	Propozim – ligji për ndryshimin e Ligjit për Mbrojtje Shëndetësore	
Ministria e Shëndetësisë	Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Sigurim Shëndetësor	
Ministria e Shëndetësisë	Propozim – ligji për Motra Medicinale dhe Akushere	
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Propozim – ligji për ndryshimin e Ligjit për Universitete të Hapura Qytetare për Mësim të Përhershëm	
Министерство за образование и наука/ Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Propozim – ligji për ndryshimin e Ligjit për Universitete të Hapura Qytetare për Mësim të Përhershëm	
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspeksionin Arsimor	
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Propozim – ligji për ndryshimin e Ligjit për Akademinë e Sportit	
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Sigurimin Pensional- Invalidor	✓
Ministria e Punës Dhe Politikës Sociale	Propozim – ligji për ndryshimin e Ligji për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara	✓
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	Propozim – ligji për Mbështetje Financiare të Kategorive të Rrezikuara të Qytetarëve për Përballimin e Krizës Energjetike	
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	Propozim – ligji për Organizimin e Organeve të Administratës Shtetërore	✓
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	Propozim – ligji për Nëpunësit Administrativ	✓
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	Propozim – ligji për të Punësuarit në Sektorin Publik	✓

Në vitin 2022, ministrinë kanë përdorur edhe mekanizma të tjerë për përfshirjen e organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim-ligjeve dhe akte tjera. Sipas përgjigjeve në Pyetësor, 8 ministri kanë shfrytëzuar mendime me shkrim nga organizatat qytetare të dorëzuara me kërkesë të ministrisë, 6 ministri kanë shfrytëzuar analizat/raportet e organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim - ligjeve dhe akteve tjera, 5 ministri kanë kryer konsultime nëpërmjet faqes së internetit të ministrisë, 5 ministri kanë organizuar takime me organizatat qytetare dhe 5 ministri kanë organizuar debate publike.





Lidhur me pyetjen si e vlerësojnë kontributin e organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave për 20% nga përcaktimi i propozim – ligjeve në vitin 2022, ministritë konsiderojnë se kontributi i organizatave qytetare është i kënaqshëm për 16.67% të propozim - ligjeve se është thelbësore për 15% të propozim - ligjeve vlerësuan se kontributi ishte i pamjaftueshëm, ndërsa për 48.33% nga përcaktimi i propozim – ligjeve ministritë nuk janë deklaruar.



3.1 Ministria e Mbrojtjes

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2022, nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ishte përcaktuar 1 propozim - ligj nga kompetenca e Ministrisë së Mbrojtjes (Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut) dhe i njëjti fillimisht ishte publikuar në RVNE në dhjetor të vitit 2020. Për Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk është formuar grupi i punës. Ministria e Mbrojtjes ka zhvilluar konsultime nëpërmjet RVNE-së si një nga mekanizmat për përfshirjen e

organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim-ligjeve dhe kontributi i organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave e vlerëson si thelbësore.

3.2 *Ministria e Punëve të Brendshme*

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2022, nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut janë përcaktuar 2 propozime - ligje nga kompetenca e Ministrisë së Punëve të Brendshme (Propozim- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontrollin Kufitar dhe Propozimi i ligjit për plotësimin e Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit të Shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut), dhe në RVNE është publikuar njëri prej tyre (Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontroll Kufitar). Sipas të dhënave të marra nga ministria, është formuar grupi i punës për Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Kontroll Kufitar, por në të njëjtin nuk kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave qytetare. Ministria e Punëve të Brendshme për këtë ligj ka bërë konsultime nëpërmjet RVNE- së si një nga mekanizmat për përfshirjen e organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim - ligjeve, si dhe konsultime nëpërmjet faqes së internetit të ministrisë dhe kontributi i organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave e vlerëson si të pamjaftueshme. Për Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit të Shtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk është formuar grupi i punës, e as nuk është zhvilluar procesi i konsultimeve nga RVNE, për shkak të propozim – ligjit që është shqyrtuar me procedurë të shkurtuar.

3.1 *Ministria e Drejtësisë*

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2022, nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut janë përcaktuar gjithsej 10 propozim-ligje nga kompetenca e Ministrisë së Drejtësisë (Propozim- ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Infrastrukturën Kombëtare të të Dhënave Hapësinore të Republikës së Maqedonisë, Propozim- ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje, Propozim-ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pagat e Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pagat e Gjyqtarëve, Propozim – ligji për ndryshimin e Ligjit për Pagat e Prokurorëve Publikë, Propozim ligji për ndryshimin e Ligjit për Shërbim Gjyqësor, Propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për Shërbim Publik të Prokurorisë, Propozim- ligji për ndryshimin e Ligjit për Pagat e Anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Propozim - ligji për Ekspertizë), dhe në RVNE janë publikuar 3 prej tyre (Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Infrastrukturën Kombëtare të të Dhënave Hapësinore të Republikës së Maqedonisë, Propozim - ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje dhe Propozim - ligji për Ekspertizë). Nga Ministria e Drejtësisë janë marrë të dhëna vetëm lidhur me Ligjin për Fyerje dhe Shpifje, për të cilin ishte formuar grupi i punës me përfaqësues nga sektori civil. Ministria e Drejtësisë ka përdorur disa mekanizma për përfshirjen e organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim- ligjeve dhe akteve tjera, përkatësisht: konsultime nëpërmjet RVNE-së; nëpërmjet faqes së internetit të ministrisë; mendime me shkrim nga organizatat qytetare të dorëzuara me kërkesë të ministrisë; takime

me organizatat qytetare dhe përdorimi i analizave/raporteve të organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim - ligjeve dhe akteve tjera, ndërsa kontributi i organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave e vlerëson si thelbësore.

3.5 *Ministria e Financave*

Në periudhën janar – dhjetor të vitit 2022, nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut janë përcaktuar 16 propozim-ligje nga kompetenca e Ministrisë së Financave (Propozim - ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Propozim- ligji për ndryshimin e Ligjit për Kryerjen e Punëve për Përfaqësim në Procedurat Doganore, Propozim - ligji për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave, Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (dy ndryshime), Propozim - ligji për plotësimin e Ligjit për Akciza, Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Përdorimin dhe Asgjësimin me Sendet në Pronësi të Shtetit dhe me Sendet në Pronësi të Komunës, Projektligji për inspektimin financiar në sektorin publik, Propozim - ligji për ndryshimin e Ligjit për Disiplinë Financiare, Propozim - ligji për Shndërrimin e Kërkesave të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të Detyrimeve të Paguara ndaj Kreditorëve të Huaj në Depozitë të Përhershme në Ndërmarrjen Publike Sistemin Kolektor, Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Drejtorinë e të Ardhurave Publike, Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatim mbi të Ardhurat Personale, Propozim Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin mbi Fitim, Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Taksat Administrative, Propozim – ligji për ndryshimin e Ligjit për Kthimin e një pjese të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar të Personave Fizik dhe Propozimi – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Financiare), ndërsa në RVNE janë publikuar gjithsej 6 ligje (Propozimi – ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Propozim – ligji për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave, Propozim – ligji për Inspektimin Financiar në Sektorin Publik, Propozim - ligji për ndryshimin e Ligjit për Disiplinën Financiare, Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Propozim – ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Financiare). Sipas të dhënave të marra nga ministria, grupe të punës janë formuar vetëm për 2 ligje, përkatësisht: Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Propozim - ligji për ndryshimin e Ligjit për kthimin e një pjese të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Grupet e punës përbëhen nga anëtarë të Ministrisë së Financave dhe DAP me qëllim të zbatimit të drejtë dhe të plotë të dispozitave ligjore dhe në to nuk morën pjesë përfaqësues të organizatave qytetare. Përveç RVNE-së, Ministria e Financave ka përdorur edhe forma tjera të konsultimeve me sektorin civil, siç janë: mendime me shkrim nga organizatat qytetare të dorëzuara me kërkesë të ministrisë, takime, debate publike dhe përdorim të/raporteve të organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim - ligjeve dhe akteve tjera. Lidhur me atë si e vlerësojnë kontributin e organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave, nga ministria konsiderojnë se për disa ligje procesi ka qenë i kënaqshëm, ndërsa për disa prej tyre i pamjaftueshëm.

3.5 *Ministria e Ekonomisë*

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka



përcaktuar 10 propozim-ligje në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë (Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektim Teknik, Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Themelimin e Agjencisë për Energjetikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Propozim-ligjin për Kërkesat Teknike për Produktet dhe Vlerësimi i Konformitetit Propozim - ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Energjetikë, Propozim - ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Efikasitet Energjetik, Propozim -ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Koncesionet dhe Partneritetet Publiko- Private, Propozim-ligjin për Kooperativat dhe Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Zonat Zhvillimore Industriale Teknologjike), dhe gjithsej 5 ligje janë publikuar në RVEN (Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektim Teknik, Propozim - ligji për Kërkesat Teknike të Produkteve dhe Vlerësimi i Konformitetit, Propozim - ligji për Mbrojtje të Konsumatorëve, Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Energjetikë dhe Propozim-ligji për Kooperativat). Në përputhje me të dhënat nga ministria, janë formuar grupe punuese për 2 ligje (Propozim - ligji për Mbrojtje të Konsumatorëve dhe Propozim - ligj për Kooperativat). Përveç RVEN, Ministria e Ekonomisë ka përdorur edhe forma tjera të konsultimit me sektorin civil siç janë: konsultime përmes faqes së internetit të ministrisë; mendime të formës së shkruar nga organizatat qytetare të dorëzuara në kërkesë të ministrisë; takime me organizatat qytetare; debate publike dhe përdorimi i analizave/raporteve të organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim-ligjeve dhe akteve tjera. Në lidhje me vlerësimin e pjesëmarrjes së sektorit civil në procesin e krijimit të politikave, nga ministria mendojnë që për një pjesë të ligjeve procesi ka qenë i kënaqshëm, ndërsa për një pjesë tjetër ka qenë i pamjaftueshëm.

3.6 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave

Në periudhën janar - dhjetor të vitit 2022, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar 3 Propozime - ligje në kompetencë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (Propozim - ligji për ndryshimin e Ligjit për Cilësinë e Produkteve Bujqësore, Propozim - Ligji për Zooteknikë dhe Propozim - ligji për Nënproduktet me Origjinë Shtazore), dhe 2 prej tyre janë publikuar në RVEN (Propozim - ligji për Zooteknikë dhe Propozim - ligji për Nënproduktet me Origjinë Shtazore). Në përputhje me të dhënat e marra nga ministria janë formuar grupet e punës për: Propozim-ligjin për Krijimin e Sistemit Këshillimor në Bujqësi dhe Zhvillimin Rural, Propozim-ligjin për Prodhimin Bujqësor Organik, Propozim-ligjin për Peshkimin dhe Akuakulturën, Propozim-ligjin për Verën dhe Propozim-ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm në Bujqësi.

Përfaqësues të organizatave qytetare morën pjesë në grupet punuese për përgatitjen e: Propozim-ligjit për Zooteknikë, Propozim-ligjit për Themelimin e Sistemit Këshillimor në Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe Propozim-ligjit për Verërat. Në vitin 2022, Ministria ka përdorur disa mekanizma për përfshirjen e organizatave të qytetare në përgatitjen e propozim - ligjeve dhe akteve të tjera, edhe atë: konsultimet përmes RVEN-it, mendime me shkrim nga organizatat qytetare të dorëzuara me kërkesë të ministrisë, takimet me organizatat qytetare, debatet publike dhe përdorimi i analizave/raporteve të organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim-ligjeve dhe akteve të tjera. Kontributi i organizatave qytetare në



procesin e krijimit të politikave është vlerësuar si thelbësor.

3.7 Ministria e Shëndetësisë

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar 1 propozim-ligj në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë (Propozim-Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Popullatës nga Sëmundjet Infektive.) dhe i njëjti nuk është publikuar në RVEN. Në vitin 2022 janë formuar grupet punuese për tre ligje, përkatësisht: Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen Shëndetësore, Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Sigurim Shëndetësor dhe Propozim-ligjin për Motrat Medicinale dhe Akusheret.

Ministria e Shëndetësisë ka bërë konsultime përmes RVEN për Propozim - Ligjin për Motrat Medicinale dhe Akusheret, mirëpo nuk ka dorëzuar përgjigje ndaj pyetjes se si e vlerëson kontributin e organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave.

3.8 Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar 4 propozim-ligje në kompetencë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (Propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për Themelimin e Agjencisë Kombëtare për Programet Arsimore Evropiane dhe Lëvizshmëri, Propozim ligj për ndryshimin e Ligjit për Universitetet e Hapura Qytetare për Mësim gjatë Gjithë Jetës, Propozim - ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektim Arsimor dhe Propozimi - ligji për ndryshimin e Ligjit për Akademinë e Sporteve) dhe të gjitha janë publikuar në RVEN. Në përputhje me të dhënat e marra nga ministria, për të gjitha propozim-ligjet janë formuar grupe punue nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit për shkak të harmonizimit me Ligjin e ri të Kundërvajtjeve, mirëpo në to nuk kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave qytetare. Ministria ka përdorur disa mekanizma për përfshirjen e organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim - ligjeve dhe akteve tjera edhe atë: konsultime përmes RVEN-it, mendime me shkrim nga organizatat qytetare të dorëzuara në kërkesë të ministrisë dhe takime me organizatat qytetare, ndërsa kontributin e organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave e vlerëson si thelbësore.

3.9 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar 8 propozim-ligje në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (Propozim - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rrogë Minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Propozim - Ligji për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtje Sociale, Propozim - Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, Propozim - Ligji për plotësimin e Ligjit për Marrëdhënie të Punës, Propozim - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Punësim dhe Sigurim në Rast të Papunësisë, Propozim - Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtje të Fëmijëve, Propozim - Ligji për Mbështetje Financiare për Qytetarët e Kategorive më të Prekura Sociale për Ballafaqim me Krizën Energjetike, Propozim - Ligji për ndryshim të Ligjit për Sigurim Vullnetar Kapital të Financuar Pensional dhe Propozim - Ligji për ndryshim të Ligjit për Punësim të Personave



Invalidor), ndërsa në RVEN është publikuar vetëm Propozim - Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtje Sociale. Sipas të dhënave të marra nga ministria, janë formuar grupe të punës për 4 ligje edhe atë: Propozim - Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, Propozim - Ligji për ndryshim të Ligjit për Punësimin e Personave Invalid, Propozim - Ligji për Mbështetje Financiare për Qytetarët e Kategorive më të Prekura Sociale për Ballafaqim me Krizën Energjetike dhe Propozim - Ligji për Barazi Gjinore, ndërsa në 3 prej tyre kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave qytetare. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka përdorur disa mekanizma për përfshirjen e organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozimeve të ligjeve edhe akteve tjera edhe atë: konsultime përmes RVEN, mendime me shkrim nga organizatat qytetare të dorëzuara me kërkesë të ministrisë, takime me organizatat qytetare dhe debate publike, ndërsa kontributi i organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave është vlerësuar si thelbësor, i mjaftueshëm ose pamjaftueshëm varësisht se për cilin ligj bëhet fjalë.

3.10 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar 1 propozim-ligj në kompetencë të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës (Propozim - Ligji për ndryshimin e Ligjit për Nëpunësit Administrativ) dhe i njëjti nuk është publikuar në RVEN. Sipas të dhënave të marra nga ministria, janë formuar grupe pune për Propozim-ligjin për Organizim të Organeve të Administratës Shtetërore, Propozim-ligjin për Nëpunësit Administrativ dhe Propozim-ligjin për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës kontributin e organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave e vlerëson si i kënaqshëm.

3.11 Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar 4 propozim-ligje në kompetencë të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve (Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbimet Postare, Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Transportin Rrugor, Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Sigurinë në Sistemin Hekurudhor dhe Propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për Ndërtim), por asnjë nga ato nuk janë publikuar në RVEN. Sipas të dhënave të marra nga ministria, për ligjet nuk janë formuar grupe të punës, as nuk janë përdorur mekanizma tjera për përfshirjen e organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozimeve të ligjeve dhe akteve tjera. Ministria nuk është deklaruar në lidhje me kontributin e organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave.

3.12 Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Në periudhën janar-dhjetor të vitit 2022 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka përcaktuar 1 propozim-ligj në kompetencë të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (Propozim-ligj për Shpallje të Studençishko Bllato për Zonë e Mbrojtur- Park i Natyrës) dhe i njëjti është publikuar në RVEN. Sipas të dhënave të marra nga ministria, është formuar grup i punës për ligjin i cili është përpunuar në bazë të studimit të valorizimit të bërë



nga Shoqëria e Konsultimit Ekologjik, në periudhën nga korriku të vitit 2019 deri në mars të vitit 2020.

Në përgatitjen e Studimit është përfshirë ekipi i ekspertëve të shkencëtarëve profesionistë, të punësuar në Institutin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore në Shkup dhe Entin Hidrobiologjik nga Shkupi.

Studimi është përgatitur në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Rregulloren për përmbajtjen e studimit për valorizimin ose revalorizimin e zonës së mbrojtur ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 26/12).

Gjatë përgatitjes së Studimit, u realizua komunikimi me palët përfaqësuese, analiza e planeve për zhvillimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, madhësinë e zonës, popullsinë e saj, nevojat e popullsisë dhe vlerat tradicionale, dhe u përcaktua se kategoria e parkut natyror pasqyron më së miri vlerën e lokalitetit. Përveç RVEN-it, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ka kryer konsultime përmes faqes së internetit, mendime të shkruara nga organizata qytetare të dorëzuara me kërkesë të ministrisë, debate publike dhe përdorim të analizave/raporteve të organizatave qytetare gjatë përgatitjes së propozim - ligjeve dhe akteve tjera, me çka kontributin e organizatave të qytetare në procesin e krijimit të politikave e vlerësojnë si të kënaqshëm.

Gjatë vitit 2022 nuk janë përcaktuar propozim-ligje nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nën kompetencën e Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bahkësive dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

3. Shqyrtime dhe rekomandime përfundimtare për avancimin e procesit të konsultimit dhe pjesëmarrjes së organizatave qytetare në krijimin e politikave publike

Nga analiza mund të konstatohet se gjatë vitit 2022 ministrinë kanë zhvilluar konsultime dhe kanë përfshirë organizatat qytetare në procesin e krijimit të politikave dhe përgatitjes së propozim - ligjeve. Në vitin 2022 janë dorëzuar gjithsej 10 komente nga organizatat qytetare për ligjet e propozuara të publikuara në RVEN, ose 23,26% e komenteve të përgjithshme të dorëzuara (43), që paraqet një rritje prej 9,56% krahasuar me vitin 2021 (13,7%), kur organizatat qytetare kanë dorëzuar 17 komente (nga gjithsej 124).

Pjesëmarrja e organizatave qytetare në grupet e punës të formuara nga ministrinë për përgatitjen e propozim-ligjeve ka shënuar gjithashtu rritje prej 11,37% në vitin 2022, kur nga gjithsej 26 grupe pune të krijuara, organizatat qytetare përfaqësohen nga përfaqësues të tyre në 12 (46,15%), për dallim nga viti 2021, kur nga gjithsej 46 grupe pune të krijuara, organizatat qytetare kishin përfaqësuesit e tyre në 16 (34,78%).

Kontributi i organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave, sipas vlerësimit të

ministrive, është ulur në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021. Në vitin 2022, kontributi i organizatave qytetare për 16,67% të propozim - ligjeve vlerësohet thelbësor, në ndryshim nga viti 2021 kur kjo përqindje është 14,3%, dhe vlerësimi për kontributin e pamjaftueshëm të organizatave qytetare në vitin 2022 (15 %) dhe 2021 (14.3%). Megjithatë, ka një dallim të madh sa i përket vlerësimit të kontributit të kënaqshëm të organizatave qytetare në vitin 2022 (20%) dhe 2021 (57.1%), sepse për 48.33% të propozim - ligjeve të përcaktuara në vitin 2022, ministrinë nuk kanë dhanë një përgjigje konkrete në pyetjen se si e vlerësojnë kontributin e organizatave qytetare.

Në maj të vitit 2022, Qeveria miratoi një kornizë të re rregullatore dhe metodologjike për përgatitjen, monitorimin dhe raportimin e strategjive sektoriale, për të siguruar përputhjen dhe koherencën midis dokumenteve të ndryshme të planifikimit të qeverisë dhe një shkallë më të lartë të zbatimit të prioritetëve strategjike dhe qëllimeve prioritare të Qeverisë. Sipas kapitullit 4 të Udhëzuesit për strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale dhe multisektoriale (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 122/22), organet e administratës shtetërore planifikonin dhe siguronin pjesëmarrjen e palëve të interesuar gjatë të gjitha fazave të procesit të përgatitjes së strategjisë dhe planit të veprimit.

Konsultimet me palët e interesuara, përfshirë organizatat qytetare, kryhen duke kërkuar mendime me shkrim, duke marrë pjesë në grupe pune, takime dhe duke përdorur mjete elektronike interaktive të disponueshme në portalin RVEN dhe faqen e internetit të organit të administratës shtetërore (neni 26 paragrafi 3).

Nga maji deri në fund të vitit 2022 nuk është miratuar asnjë strategji sektoriale dhe strategjitë që janë duke u përgatitur do të jenë objekt analize në Raportin për vitin 2023 (Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2023-2030, Strategjia e Transparencës 2023-2026, Strategjia e Zhvillimit për konceptin e Një Shoqëri për të Gjithë 2023-2025, Strategjia Kombëtare për të Rinjtë 2023-2027, Strategjia për Promovimin e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara 2023-2030, etj.).

Me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit të Qeverisë dhe organeve të administratës shtetërore me organizatat qytetare në procesin e krijimit të politikave dhe përmirësimin e cilësisë së këtij procesi duke shfrytëzuar ekspertizën e shoqërisë civile, është e nevojshme që organet e administratës shtetërore të vazhdojnë komunikimin e rregullt dhe konsultimi me organizatat qytetare në të gjitha fazat e procesit të krijimit të politikave, që nga momenti i fillimit të planifikimit, deri në përgatitjen e tekstit të propozimit për një ligj, strategji apo akt tjetër.

Në të njëjtën kohë, konsultimet duhet të jenë të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese dhe organet e administratës shtetërore, krahas publikimit të detyrueshëm të propozim - ligjeve dhe strategjive për Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional të Rregulloreve (RVEN), të praktikojnë edhe metoda të tjera konsultimi, si: përfshirja e përfaqësuesve të organizatave qytetare në grupet e punës, mbajtja e takimeve konsultative dhe debateve publike etj.

Në të njëjtën kohë, organet e administratës shtetërore duhet të përdorin analizat dhe dokumentet e tjera të përgatitura dhe të publikuara nga organizatat qytetare si bazë në procesin e krijimit të politikave dhe pas konsultimeve dhe analizave të realizuara të iniciativave, propozimeve apo vërejtjeve të marra nga organizatat qytetare, të publikojnë raport mbi konsultimet, në faqen e tyre të internetit dhe/ose në RVEN (për propozim - ligjet - në Raportin e vlerësimit të ndikimit të rregullativëd), i cili do të përfshijë analizë të procesit të konsultimit dhe rekomandimeve të marra. Këto aktivitete duhet të plotësohen me masa për të forcuar kapacitetet e nëpunësve administrativë për të përfshirë organizatat qytetare dhe publikun në të gjitha fazat e krijimit të politikave dhe përgatitjes së ligjeve dhe strategjive, por edhe për të forcuar ndërgjegjësimin e qytetarëve për mundësitë e përfshirjes në proceset e krijimit të politikave të Qeverisë dhe organeve të administratës shtetërore.

Rekomandime:

- Organet e administratës shtetërore të vazhdojnë me komunikimin dhe konsultimin e rregullt me organizatat qytetare në të gjitha fazat e procesit të krijimit të politikave dhe përgatitjes së propozim - ligjeve, strategjive dhe akteve tjera, duke përfshirë edhe si anëtarë në grupe të punës, ndërsa konsultimet të jenë të besueshme, gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese.
- Gjatë analizimit të situatës në procesin e krijimit të politikave, organet e administratës shtetërore duhet të përdorin dokumentet (analiza, raporte, etj.) të përgatitura nga organizatat qytetare.
- Ministritë kompetente duhet të publikojnë propozim - ligjet në Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional të Rregulloreve (RVEN) dhe të mundësojnë konsultimet me palët e interesuara për të paktën 20 ditë nga dita e publikimit, dhe raporti mbi vlerësimin e ndikimit të rregullativës duhet të përmbajë pasqyrë të mendimeve të marra në të cilat do të cekën arsyet pse nuk pranohen vërejtjet dhe propozimet.
- Për të siguruar përfshirje në kohë të organizatave qytetare, organet e administratës shtetërore, në Regjistrin e Vetëm Elektronik Nacional të Rregulloreve (RVEN), si dhe në faqen e tyre të internetit duhet të publikojnë njoftim me kornizë kohore për përgatitjen e strategjisë dhe të mundësojnë kontroll dhe dorëzim të komenteve në tekstin e projekt-strategjisë.

